

V E N D I M  
“PËR ÇAKTIMIN E MASËS SË SIGURIMIT”

*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :*

*Gjyqtare : Rezarta BALLIU (VIGANI)*

asistuar prej sekretares gjyqësore Beglie Nura dhe me pjesmarrjen e prokurores Elona Alvora, sot datë 16.07.2010 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale në ngarkim të te,

PANDEHURIT:            *B.B, i biri i (.....) dhe (.....), datl. (.....), lindur dhe banues ne (.....),shteti private (.....), me arsim te mesem, me profesion bujk, i padënuar, me kombësi kosovare,mbrojtur nga Av. Skender Allmeta me Nr.1573 Liçense dhe NIPT K 72113014 N.*

OBJEKT :        *Vendosje e sekuestros konservative.*

BAZA LIGJORE: *Neni 274 e vijues i K.Pr.Penale*

- 1. Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e prokurores e cila kërkoi –caktimin si mase sigurimi ate te sekuestros konservative, shtetasi i cili ishte dakort me kerkesen e prokurorise dhe avokatin e tij i cili kerkoj mospranimin e kerkeses dhe pasi e bisedoi dhe shqyrtoi çështjen në tërësinë e saj,*

**V Ë R E N**

Me datën 19.06.2010,shtetasi B.B ka shkuar ne aeroportin e Rinasit per te udhetuar me nje pasaporte bullgare me emrin e tij e nr.(.....)

Kontrollori i policise kufitare ka dyshuar se pasaporta ishte e fallsifikuar pasi, gjate kontrollit teknik ajo paraqiste nderhyrje dhe keto dyshime u mbeshteten edhe nga verifikimi paraparak i kryer nga Laboratori Kriminalistik i Rinasit.

Po keshtu, sipas policise gjyqësore, nga kontaktet me konsullin bullgar referohet qe dokumentat nuk duhet te jene origjinale bullgare, pasi prej te lartpermendurit mohohet qe te jene dhene shtetasi per shtetas kosovare, ndaj as nuk mund te jene leshuar paraporta per ta.

Sa siper, prokuroria ne date 19.06.2010 ka bere arrestimin ne flagrante te shtetasit B.B dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, me vendimin e saj me Nr. 610 Akti date 21.06.2010 ka vendosur:

- 2. Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit, ndaj shtetasit B.B dhe lënien e saj në fuqi .*
- 3. Caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit B.B atë të “Arrestit në burg”, dyshuar për veprën penale të “Fallsifikimit të leternjoftimeve, pasaportave ose vizave”, parashikuar nga neni 189 i K.Penal.*

Prokuroria ne vijim te veprimeve te saja procedurale hetimore ka kryer ekspertimet teknike te dokumentave te shtetasit B.B dhe nga akti i ekspertimit me nr.5134 date 24.06.2010 ka rezultuar:

1-Ne pasaporten Bullgare te shtetasit B.B me nr. (.....) objekt ekspertimi u konstatuan nderhyrje fallsifikuese.

2-Ne dokumentin “Identity Card” me nr. (.....) ne emer te shtetasit B.B u konstatuan nderhyrje fallsifikuese.

3-Ne dokumentin “Leje e drejtimit te automjetit” me nr.(.....), ne emer te B.B u konstatuan nderhyrje fallsifikuese.

Nga procesverbali i kontrollit personal date 19.06.2010 rezulton se ne sendet e te pandehurit B.B ndodhen edhe 490 (*katerqind e nentedhjetë*) EURO.

Nisur nga ky fakt, per te paguar edhe shpenzimet procedurale nga ana e te pandehurit,

prokuroria kerkoi qe te vendoset sekuestro konservative mbi kete shume parash, kerkese

kjo e bazuar ne nenet 270 e vijues te K.Pr.Penale.

Gjykata pasi e shqyrtoi kerkesen e organit të akuzës për të vendosur sekuestron

konservative, cmon se kjo kerkese është e mbështetur në ligj dhe si e tillë u pranua .

### PËR KËTO ARSYE

*Gjykata në bazë të nenit 270 e vijues të K.Pr.Penale*

### V E N D O S I

- Të caktoj si mase sigurimi pasuror ate te ‘Sekuestros Konservative’ ndaj te pandehurit B.B.
- Urdherohet Policia Gjyqesore Tirane per ekzekutimin e ketij vendimi.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 10 ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë.
- U shpall sot me date 16/07/2010 Tiranë.

**SEKRETARE**

**GJYQTARE**

**Beglie NURA**

**Rezarta BALLIU (Vigani)**